

Parafjalë

Libri mbi artistin e madh Bojan Adamiç dhe periudhën, deri më sot pak të njohur, që ai ka kaluar në Shqipëri, është rezultat i informacionit të mbledhur nga të gjitha drejtimet, i rastësive fatlume dhe i punës së përkushtuar të shumë njerëzve që e respektojnë dhe e duan punën e tij.

Bojan Adamiç është një emër i njohur në Slloveni, i cili përfaqëson, para së gjithash, njërin nga kulmet e krijimtarisë artistike sllovene dhe jugosllave në fushën e muzikës në shekullin XX. Unë i takoj atij brezi, që, me përmendjen e emrit të tij, kujton shumë melodi që janë fryt i talentit të tij të veçantë dhe shumë prej të cilave i përcjell me fishkëllimë, pa ditur se këto janë vepra të mjeshtërit të madh.

“Pas Luftës së Dytë Botërore, Bojan Adamiçi ishte në Shqipëri”, është kjo një fjali e shkurtër, të cilën ma tha para fillimit të mandatit tim në Tiranë, në vitin 2019, vjehri im, ambasadori Ramadan Marmullaku, njohës i mirë dhe adhures i Shqipërisë.

Fjalja e vjehrrit tim u bë shkas që një ditë, në kohën e masave kufizuese për shkak të pandemisë Covid-19, u ula para kompjuterit dhe pashë se çfarë mund të gjendet me kombinacionin kërkues Bojan Adamiç dhe Shqipëria. Rezultatet ishin interesante, por relativisht modeste. Zbulimi kryesor ishte faqja e internetit mbi jetën dhe veprën e tij, ku përshkruhej shkurtimisht edhe episodi në Shqipëri.

Për faqen e internetit përkujdeset e bija e tij, znj. Alenka Adamiç, e cila e mbështeti idenë që, në bashkëpunim me ambasadën, të ndihmojë në përgatitjen e një aktiviteti lidhur me kohën e babait së saj në Shqipëri. Me materialin që e kishte ruajtur me kujdes dhe me të dhënat që m'i dërgoi hapi rrugën deri te partnerët shqiptarë në projekt.

Bashkëpunëtorja shqiptare në ambasadën sllovene, znj. Dasareta Mitro, adhures e madhe e kulturës, me një diapazon të gjerë dhe e mirinformuar, gjeti menjëherë personin e duhur. Prof. Vasil Tole, muzikolog dhe nënkryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e dëgjoi me interesim të sinqertë tregimin që nuk e kishte njohur më parë. Jeta e Adamiçit, vepra dhe krijimtaria e tij në Tiranë e pasluftës, angazhimi, vëzhgimet e hollësishme dhe bashkëpunimi me artistët shqiptarë, mes të cilëve edhe me kompozitorin Dhora Lekaj, siç e vërejta, i lanë mbresa të thella. Nuk do ta harroj kurrë shprehjen e fyturës së tij, kur ia dorëzova kopjen e shënimit të tij të kompozimit “Sonatina”, të cilën Adamiçi, siç edhe shkruante me dorë në skajin e fletës, e kishte kompozuar në vitin 1947 në Tiranë. Për realizimin e projektit arritëm të gjenim partnerin më të mirë të mundshëm në anën shqiptare.

Rezultati ishte një seminar shkencor, që u mbajt më 4 maj 2022, pikërisht shtatëdhjetë e pesë vjet pas ardhjes së Adamiçit në Tiranë, në sallën e mbushur plot të Akademisë së Shkencave. Faktet mbresëlënëse të prezantuara në këtë ngjarje, më pak se dy vjet më vonë sollën deri te botimi i këtij libri.

Ndër rastet fatlume, që i përmenda edhe në fillim, dy janë veçanërisht interesante.

Ndër njerëzit e parë që takova kur erdha në Tiranë ishte z. Pleurat Himaduna. Në njërin nga bisedat e mëvonshme doli se Bojan Adamiçi ai e kishte njohur personalisht dhe se me të kishte bashkëpunuar në krijimin e filmave të xhiruar në Kosovë në vitet '70. Përpos kësaj, ai dinte edhe detaje të shumta mbi krijimtarinë muzikore të Adamiçit pas kthimit të tij nga Shqipëria, si dhe për bashkëpunimin e tij me artistët kosovarë në kohën e Jugosllavisë. Ndiej respekt të madh ndaj tij që këtë pjesë të jetës së Adamiçit e prezantoi në seminarin tonë shkencor.

Një tjetër rastësi ishte ndërrimi pa dashje i një valixheje në takimin e Unionit European të Transmetimeve Radiotelevizive (EBU) në Novi Sad, çka bëri që valixhja të përfundonte aksidentalisht në Tiranë. Ambasada e Sllovenisë u përkujdes që valixhja të shkojë te pronari i saj, z. Boris Bergant, njëri nga themeluesit e televizionit slloven. Doli që z. Bergant dinte shumë mirë për dërgimin e Adamiçit në Shqipëri dhe shumë detaje të tjera që lidhen me të. Për këtë i kishte folur z. Drago Koshmrl, gjithashtu nismëtar i televizionit slloven, i cili, pas Luftës së Dytë Botërore kishte punuar në Ambasadën jugosllave në Tiranë, e të cilin Adamiçi e përmend si bashkëkombësin që i kishte ofruar mbështetje gjatë qëndrimit në Tiranë.

Jam jashtëzakonisht i gëzuar që arritëm që këtë histori të veçantë dhe interesante t'ia shfaqim opinionit të gjerë dhe ta ruajmë për brezat e ardhshëm.

Bojan Adamiçi bën pjesë në personazhet më të rëndësishme që thurën lidhje ndërmjet popullit të Sllovenisë dhe të Shqipërisë. Sipas rëndësisë dhe gjurmëve që ai la, mund ta vendosim krah për krah familjeve fisnike shqiptare, që u vendosën gjatë mesjetës në Istrën sllovene dhe gjuhëtarëve sllovenë, të cilët në shekullin XIX dhe XX studiuuan gjuhën shqipe dhe e bashkëformësuan gramatikën shqipe, siç përdoret edhe në kohën e sotme.

Kontributin e tij në thellimin e raporteve njerëzore dhe në ndërtimin e urave ndërmjet kombeve e theksoi edhe zëvendësministria për Europën dhe Punët e Jashtme, znj. Megi Fino në kumtesën e saj.

I gjithë projekti paraqet një sukses të diplomacisë në fushën e bashkëpunimit kulturor. Të dhënat dhe materialet e grumbulluara flasin për të kaluarën e përbashkët europiane dhe shtrojnë rrugën për të ardhmen e përbashkët në Bashkimin Europian.

Për mua personalisht janë vërtet të çmuara fragmentet nga letrat që Adamiçi i dërgoi në shtëpi, në të cilat me një ndjeshmëri përshkruan jetën e atëhershme, zakonet dhe artin në Shqipëri. Qëkur i lexova ato, gjatë rrugëtimit tim nëpër këtë shtet i përjetoj ndryshe ballafaqimet me veçantitë dhe bukuritë e vendit dhe njerëzve të tij.

Mirënjohja për përgatitjen e librit i takon në radhë të parë ministres së Kulturës së Shqipërisë, znj. Elva Margariti, që mori iniciativën dhe e mbështeti botimin e librit.

Meritat për qasje gjithëpërfshirëse, interesante dhe profesionale të periudhës së Adamiçit në Shqipëri, të pajisur me materie të pasur u takojnë muzikologëve prof. Vasil Tole dhe prof. Darja Koter, si dhe së bijës së artistit, znj. Alenka Adamiç.

Falënderim i posaçëm i takon drejtoreshës së Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, znj. Alda Bardhyli, e cila u përfshi në krijimin e këtij libri që nga fillimi, personelit të Ambasadës së Sllovenisë në Tiranë për koordinimin dhe organizimin e të gjitha aktiviteteve, ambasadorit të Sllovenisë në Beograd, z. Damjan Bergant dhe bashkëpunëtorëve të tij, të cilët arritën të sigurojnë materialin unik arkivor, si dhe z. Pleurat Himaduna për të gjithë informacionin mbi bashkëpunimin e Adamiçit me artistët kosovarë, që na shtyn të mendojmë mbi ndikimin e qëndrimit në Shqipëri dhe punën e tij në vazhdim.

Falënderoj gjithashtu edhe bashkëshorten time Renata Japelj Marmulaku dhe vajzën time Ida Japelj, pa të cilat puna ime intensive në këtë angazhim frymëzues nuk do të ishte e mundur.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, një falënderim i posaçëm për zotin Nikollë Berishaj, që përktheu dokumentacionin në gjuhën shqipe dhe me ndjeshmëri përcolli përshkrimet e zgjedhura, vezulluese dhe interesante të Adamiçit.

Peter Japelj

Ambasador i Republikës së Sllovenisë në Republikën e Shqipërisë.